



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 1245/prot.

Pogradec, më 24 .03 2022

VENDIM

NR. 25 , DATË 23 .03 .2022

PËR

DHËNIEN E PËLQIMIT, PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE TË QYTETIT, NË FSHATIN GURAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE BUÇIMAS, BASHKIA POGRADEC.

Në mbështetje të; Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pikat 1 dhe 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomisë vendore" të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", pikës 2 të nenit 8, pikën 1.2 të nenit 9, pikës 7 të nenit 23, shkronjës "k" dhe shkronjës "n" të nenit 54, të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.8480, date 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", nenit 3 dhe nenit 8 të Ligjit Nr.9220, datë 15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit", i ndryshuar, Ligjit Nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes public", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.711, datë 29.10.2014, "Për miratimin e rregullores teknike "Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë", bazuar në relacioni i paraqitur dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI I BASHKISË

VENDOSI :

1. Të shprehë pëlqimin për shtimin e sipërfaqes në varrezat publike të qytetit, në fshatin Guras (Zagorçan), Njësia Administrative Buçimas, Bashkia Pogradec.
2. Bashkia Pogradec të marrë të gjitha masat për hartimin e projektit përkatës në përputhje me dispozitat e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.711, datë 29.10.2014, "Për miratimin e rregullores teknike "Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë" dhe evidentimin e pasurive në të cilat do të shtohet sipërfaqja e varrezave publike.
3. Efektet: Garantimi i shërbimit të varrimit në qytetin e Pogradecit.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe administrata e Bashkisë Pogradec.
5. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.
6. U shpall sot më datë ____ . ____ .2021.

KRYETAR I KËSHILLIT
Sotiraq MANGËRI



